



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA VLORE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME EKONOMIKE, TURIZMIT DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE  
DREJTORIA E FINANCËS BUXHETIT DHE KONTABILITETIT

Nr. 12744/1  
prot

Vlorë, 25.06.2026

PROJEKTVENDIM

Nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_, \_\_\_\_\_ 2026

“PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT TË PARË TË BUXHETIT  
AFATMESËM 2027-2029”

Mbështetur në Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, veçanërisht në nenin 9, pika 1, shkronja "b", nenin 34, pika 6, nenin 41, pika 1 dhe nenin 64, shkronja "c"; në Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore", veçanërisht në nenet 33, 34, 35, 36 dhe 37; në Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; në Udhëzimin nr. 9, datë 20.03.2018, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, "Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit"; në Udhëzimin Plotësues nr. 2, datë 14.01.2026, "Për Zbatimin e Buxhetit të Vitit 2026"; në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 100, datë 23.12.2025, "Për Miratimin e Buxhetit të Bashkisë për Vitin 2026", i ndryshuar; si dhe në Udhëzimin nr. 7, datë 28.02.2026, të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, "Për Përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2027–2029", duke marrë në konsideratë komentet dhe rekomandimet e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë mbi projekt-dokumentin e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2027–2029, paraqitet për shqyrtim dhe miratim Programi Buxhetor Afatmesëm i Bashkisë për periudhën 2027–2029.

VENDOSI:

1. Të miratojë programin e parë të Buxhetit Afatmesëm 2027-2029, sipas dokumentit bashkëlidhur këti vendimi.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Grupi i Menaxhimit Strategjik dhe Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", neni 55, pika 6.

Konceptoi: H.Haxhaji

Xh.Kasëmi

KRYETAR

Brunilda Mersini

ME URDHËR DHE DELEGIM  
NËNKRYETAR  
Joljana Llanaj



**BASHKIA VLORE**

**PROJEKT DOKUMENTI**

**PROGRAMI BUXHETOR AFATMESËM  
2027-2029**

**QERSHOR 2026**

**PËRMBAJTJA**

<b>LOGO</b> .....	<b>2</b>
<b>1. HYRJE</b> .....	<b>5</b>
1.1 Roli dhe Qëllimi i Programit Buxhetor Afatmesëm, si një instrument efektiv planifikimi në nivel vendor .....	5
1.2 Fazat e përgatitjes dhe miratimit të PBA-së .....	7
<b>2. VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM I BASHKISË</b> .....	<b>10</b>
2.1 Situata e Njësisë së Vetëqeverisjes Vendore.....	10
2.2 Çështje kryesore për Projektet dhe Politikat e Bashkisë .....	10
<b>3. ORIENTIMI AFATGJATË I BASHKISË</b> .....	<b>11</b>
3.1 Strategjia E zhvillimit afatgjatë.....	11
3.2 Sfidat kryesore të zhvillimit / paraqitja e projekteve kryesore – arsytet dhe përfituesit.....	11
<b>4. BUXHETI AFATMESËM I BASHKISË VLORË 2027-2029</b> .....	<b>12</b>
4.1 Të Ardhurat dhe shpenzimet publike të Bashkisë/ Qarkut Vlorë në Vitet 2027-2029 .....	13
4.1.1 Të ardhurat e parashikuara të Bashkisë Vlorë për vitet 2027-2029.....	13
4.1.2 Plani i Shpenzimeve të Bashkisë Vlorë për periudhën 2027-2029.....	17
4.2 Investimet Publike në Nivel Vendor.....	21
<b>5. BUXHETI AFATMESËM PËR PROGRAMET BUXHETORE</b> .....	<b>22</b>
5.1.1 Qëllimet dhe Objektivat e Politikës së Programit .....	22
5.1.2 Plani i Shpenzimeve të Produkteve të Programit.....	23
5.1.3 Projektet e Investimeve të Programit.....	24
5.1.4 Informacione Bazë mbi Programin.....	24
<b>6. BUXHETI VJETOR</b> .....	<b>26</b>
6.1. Dokumentacioni Bazë.....	26
6.2. Dokumentacioni Shoqërues .....	26

**Lista e Tabelave**

Tabela 1. Informacion Bazë mbi Bashkinë/Qarkun Vlorë .....	12
Tabela 2. Të Ardhurat e Bashkisë sipas Burimit.....	13
Tabela 3. Shpenzimet totale të Bashkisë sipas kategorive ekonomike .....	17
Tabela 4. Shpenzimet totale të Bashkisë sipas programit dhe kategorive ekonomike.....	19
Tabela 5. Shpenzimet e NJVQV sipas Klasifikimit Funkcional (Niveli I, II, III i COFOG).....	20
Tabela 5. Shpenzimet e Programit sipas Kategorive ekonomike.....	22
Tabela 6. Qëllimet dhe Objektivat e Politikës së Programit.....	22
Tabela 7. Planet e Shpenzimeve të Produkteve të Programit.....	23
Tabela 8. Projektet e Investimeve të Programit .....	24
Tabela 9. Informacione bazë mbi klasifikimet e programit .....	24

*Lista e Shkurtimeve*

PBA	– Programi Buxhetor Afatmesëm
NJVV	– Njësi e Vetëqeverisjes Vendore
EMP	– Ekipi i Menaxhimit të Programit
GMS	– Grupi për Menaxhimin Strategjik
MF	– Ministria e Financave
FPT	– Instrumenti i Planifikimit Financiar
INSTAT	– Instituti i Statistikave
PBB	– Produkti i Brendshëm Bruto
SMBV	– Sistemi i Menaxhimit të Buxhetit Vendor

## 1. HYRJE

### 1.1 Roli dhe Qëllimi i Programit Buxhetor Afatmesëm, si një Instrument Efektiv Planifikimi në Nivel Vendor

Programi Buxhetor Afatmesëm (PBA) është një instrument për prezantimin në mënyrë të integruar e disavjeçare të parashikimit të të ardhurave dhe burimeve financiare publike dhe për planifikimin, menaxhimin dhe lëvrimin e shërbimeve publike. Si i tillë, ai është një komponent kryesor i planifikimit kombëtar dhe vendor.

Strategjia Kombëtare e Zhvillimit, Strategjitë Sektoriale dhe Planet e Përgjithshme Vendore shpjegojnë atë që qeveria synon të arrijë në fushat kryesore të ofrimit të shërbimeve, cilat struktura të qeverisë do të përfshihen dhe si do të ndërveprojnë me organizatat e sektorit privat dhe aktorë të tjerë joqeveritarë. Si të tilla, ato përshkruajnë mënyrën sesi qeveria synon të zhvillojë komponentët kryesorë të ofrimit të shërbimeve, investimet kryesore publike që do të kërkojnë dhe implikimet përkatëse për nivelin dhe llojin e shërbimeve publike që do të ofrohen. Aspekti strategjik i këtyre dokumenteve i jep formë kërkesave për shpenzime për investime publike si dhe për ofrimin e shërbimeve gjatë periudhave disavjeçare.

Ashtu si edhe nivelet e tjera të qeverisjes, Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore (NJVQV-të) janë përgjegjëse për menaxhimin e fondeve publike. Kjo përfshin mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore dhe menaxhimin e burimeve kombëtare që transferohen në bashki nga qeveria qendrore, disa prej të cilave kushtëzohen për shërbime specifike. Kjo do të thotë se kërkohet një instrument për të projektuar burimet e përgjithshme të disponueshme për shpenzimet vendore, duke përfshirë këtu: grantet, huatë, taksa e tarifave vendore dhe transferime nga qeveria qendrore (të kushtëzuara dhe të pakushtëzuara).

Njësitë e vetëqeverisjes vendore ofrojnë shërbime publike vendore bazuar në kompetencat që u jep ligji. Si rrjedhojë, kjo kërkon një instrument për të lehtësuar dhe menaxhuar mënyrën e përdorimit të burimeve gjithsej, duke përfshirë vendimet për llojin e shpenzimeve (pagat dhe sigurimet; mallrat dhe shërbimet, interesat e borxhit, ripagimi i huave dhe kështu me radhë), si dhe vendimet strategjike se si do të alokohen burime midis llojeve të ndryshme të shërbimeve publike (sigurisë publike, arsimit, shëndetësisë, punëve publike dhe kështu me radhë).

Procesi i PBA-së, prezanton në mënyrë të integruar informacionin mbi parashikimet e të ardhurave dhe burimeve gjithsej dhe përcakton objektivat përse do të shpenzohen ato, kostot e nevojshme dhe llojin e secilit shërbim që do të ofrohet. Ndër të tjera, kjo përfshin lidhjen e qëllimeve dhe objektivave të bashkisë me qëllime strategjike të përcaktuara në strategjitë lokale dhe kombëtare. Procesi i PBA-së, disiplinon maturinë financiare vendore duke planifikuar shpenzimet publike brenda një kuadri realist financiar vendor. Në të njëjtën kohë, ai synon të garantojë që shërbimet publike vendore plotësojnë nevojat në rritje të banorëve duke treguar se si shpenzimet publike për prioritetet strategjike të zhvillimit të njësisë vendore përkthehen në vendime konkrete për ofrimin e shërbimeve publike vendore, me lidhje të qarta mes politikave vendore dhe prioriteteve vjetore të shpenzimeve .



Në procesin e PBA-së planifikimi dhe buxheti vendor afatgjatë e ndihmon njësinë vendore të planifikojë sesi shërbimet publike do të evoluojnë me kalimin e kohës, duke përcaktuar kërkesat disavjeçare të shpenzimeve në fusha të ndryshme të ofrimit të shërbimeve në përputhje jo vetëm me ndryshimet e parashikuara në demografinë, por edhe në përputhje me ndryshimin e nevojave të banorëve të bashkisë. Kombinimi i këtij informacioni me parashikimin për nevojat dhe burimet në dispozicion në të ardhmen, u mundëson njësinë vendore që të planifikojnë shërbime publike në mënyrë të qëndrueshme, si dhe të zhvillojnë një kuadër afatmesëm të burimeve si bazë për planifikimin afatmesëm të shpenzimeve.

Gjithashtu, procesi i PBA-së siguron një kornizë për planifikimin e investimeve publike sipas programeve buxhetore duke përfshirë edhe kërkesat për shpenzimeve korente. Kjo siguron një bazë të fortë mbi të cilën mund të merren vendimet për investime, të lidhura me planet strategjike dhe planet afatmesme për zhvillimin e shërbimeve të ndryshme publike që njësinë vendore ofron për banorët.

Në mënyrë të përmbledhur Programi Buxhetor Afatmesëm përfshin këto procese:

- prezanton informacionin mbi të ardhurat dhe burimet e disponueshme të bashkisë;
- përkthen vizionin strategjik të NJVQV-së në plane praktike për ofrimin e shërbimeve gjatë një periudhë disavjeçare;
- shpërndan burimet sipas fushave të veçanta të ofrimit të shërbimeve publike,
- përcakton treguesit e performancës në secilën fushë të ofrimit të shërbimeve;
- llogarit kërkesat vjetore të shpenzimeve (korente dhe për investime) në përputhje me objektivat dhe treguesit e performancës për një periudhë disavjeçare; dhe
- përcakton treguesit vjetorë të performancës në përputhje me parashikimet për burimet në dispozicion përgjatë një periudhe disavjeçare.

Në qendër të PBA-së janë dy procese planifikimi dhe buxheti që NJVQV-të ndërmarrin për të planifikuar treguesit e performancës dhe shpenzimet afatmesme, si dhe propozimet për buxhetet vjetore:

- Përcaktimi i Qëllimeve dhe Objektivave të Programit (nëpërmjet Rishikimit të Politikës së Programit);
- Planifikimi i Shpenzimeve të Programit (në funksion të ofrimit të shërbimeve).



Procesi i *Planifikimit të Shpenzimeve të Programit*, synon të përcaktojë sasinë dhe koston e të gjitha shërbimeve publike që NJVQV-ja planifikon të ofrojë gjatë çdo viti të periudhës afatmesme, të shprehura në formën e produkteve SMART të programit. NJVQV-ja, specifikon produkte që sigurojnë arritjen e të gjitha Objektivave të Programit, Qëllimeve të Politikës së Programit si dhe standarteve e treguesve të performancës të lidhura me ato.

Si të tilla, proceset e Rishikimit të Politikës së Programit dhe Planifikimi i Shpenzimeve të Programit përfaqësojnë zëmërën e procesit të PBA-së, dhe informacioni i gjeneruar nga këto procese paraqitet në mënyrë të detajuar në Seksionin 3, të dokumentit të PBA-së. Këto qëllime, objektiva, standarde dhe produkte përbëjnë kornizën e performancës për shërbimet publike të NJVQV.

Një element i rëndësishëm i procesit të përgatitjes së PBA-së është specifikimi i Treguesve të Performancës (SMART) për secilën fushë të funksioneve të bashkisë. Kjo përfshin planifikimin dhe kostimin e detajuar të treguesve të performancës brenda secilit funksion të qeverisjes vendore, si dhe prezantimin e këtyre treguesve për miratim tek vendimmarrësit dhe më pas për publikun e gjerë në formën e:

- Produkteve SMART, që specifikojnë në detaje shërbimet publike të planifikuara për t'u ofruar;
  - Objektivave SMART të Politikës së Programit (dhe treguesve të performancës të lidhura me ato), që specifikojnë arritjet kryesore vjetore nga ofrimi i shërbimeve publike;
  - Qëllimeve SMART të Politikës së Programit (dhe treguesve të performancës të lidhura me ato), që bashkia planifikon të arrijë në periudhën afatgjatë;
  - Kostot totale të ofrimit të shërbimeve vendore, duke treguar se si njësia vendore planifikon të përdorë burimet në dispozicion;
  - Kostot e planifikuara për produktet (shërbimet) individuale, në mënyrë që vendimmarrësit dhe banorët të kuptojnë efikasitetin e planifikuar në ofrimin e shërbimeve të veçanta.

## 1.2 Fazat e Përgatitjes dhe Miratimit të PBA-së

Hartimi i projektit buxhetor afatmesëm 2027 - 2029 është bërë bazuar në ligjin nr.139/2015“Për vetëqeverisjen vendore“, të ndryshuar, ligjin nr.9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar , ligjin nr.10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin, ligjin 68/2017 datë 27.4.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore “Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 23 datë 30.07.2018 “Për Procedurat Standarte të Përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm të NJVQV”; Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 9 datë 20.03.2018 “Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit” të ndryshuar, Udhëzimit nr.7 datë 28.02.2026 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Për Përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2027-2029”, si dhe V.K.B Nr.100 dt.23.12.2025, “Për Miratimin e Buxhetit të Bashkisë për Vitin 2026”.

Në kuadër të zbatimit të Programit Buxhetor Afatmesëm 2027–2029, Bashkia Vlorë operon në një kontekst të veçantë zhvillimor, të karakterizuar nga një potencial i lartë ekonomik, turistik dhe demografik, si dhe nga sfida të lidhura me menaxhimin e territorit, infrastrukturës dhe shërbimeve publike.



Si një nga njësitë kryesore bregdetare në Vlora, bashkia përballlet me rritje sezonale të popullsisë, çka ndikon drejtpërdrejt në kërkesën për shërbime publike, veçanërisht në sektorë si pastrimi, furnizimi me ujë, infrastruktura rrugore dhe menaxhimi i mbetjeve.

Në këtë kontekst, PBA 2027–2029 i Bashkisë Vlorë synon:

- të sigurojë një shpërndarje më efektive të burimeve financiare;
- të orientojë investimet drejt sektorëve prioritarë si turizmi, infrastruktura dhe shërbimet publike;
- të përmirësojë cilësinë dhe aksesin në shërbimet për qytetarët dhe bizneset;
- të forcojë qëndrueshmërinë financiare dhe disiplinën buxhetore.

Gjithashtu, procesi i planifikimit buxhetor në Bashkinë Vlorë është i lidhur ngushtë me dokumentet strategjike vendore dhe kombëtare, duke synuar harmonizimin e objektivave të zhvillimit me prioritetet e përcaktuara në nivel qendror.

Një element i rëndësishëm në këtë proces është edhe përfshirja e aktorëve lokalë, përmes konsultimeve publike dhe bashkëpunimit me grupet e interesit, me qëllim rritjen e transparencës dhe përmirësimin e vendimmarrjes.

Rolet dhe përgjegjësitë në procesin e përgatitjes së PBA-së për Kryetarin e NJVV-së, Këshillin e NJVQV, GMS, Zyrtarët Autorizues dhe Ekzekutues, Drejtuesit dhe anëtarët e EMP-ve, si dhe MF-së;

- Procedurat, fazat e ndryshme, kalendarin dhe metodologjinë për programimin dhe buxhetimin e bazuar në performancë në përgatitjen e PBA-së; Kërkesat e raportimit të programit buxhetor afatmesëm. Më konkretisht, kërkesat për të përgatitur dhe prezantuar: Misionin e njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe strukturën e programeve; Deklaratat e politikës së programeve; Tavanet e njësisë së vetëqeverisjes vendore sipas programeve; Shpenzimet e programeve sipas artikujve; Shpenzimet e programeve sipas produkteve; Projektet me financim të brendshëm; Projektet me financim të huaj; Formatet plotësuese të kërkesave buxhetore;
- Projekt planin e arkës, i cili dorëzohet në përfundim të fazës së dytë të përgatitjes së kërkesave buxhetore; Raportet e kërkesave shtesë (Kërkesat shtesë sipas produkteve; Kërkesat shtesë sipas artikujve buxhetor)

Udhëzimi Vjetor i PBA-së, përcakton kërkesat specifike për procesin e PBA-së në NJVQV duke përfshirë edhe kërkesa të veçanta për prezantimin e informacionit në këtë dokument. Aspektet kryesore të udhëzimit vjetor për Përgatitjen e PBA-së 2027-2029 përfshijnë:

- Afatet specifike për përgatitjen e dokumentit të PBA-së dhe Informacionin mbi transfertën e pakushtëzuar të përgjithshme dhe atë sektoriale për NJVQV-të;
- Procesin e përgatitjes së PBA, p.sh. proceset për përgatitjen e vlerësimit dhe parashikimit të të ardhurave; Tavanet e përgatitjes së PBA-së; Organizimit të procesit; Pemës së programeve; Draft dokumentit të PBA-së;
- Sistemin e Menaxhimit të Buxhetit Vendor (SMBV) dhe Manualin e Përdorimit të tij.

Faza 1 e procesit të PBA-së, zhvillohet midis Janarit dhe Qershorit. Kjo është faza strategjike kur merren të gjitha vendimet kryesore për financimin e politikave dhe investimeve të reja. Kjo fazë përmbyllet me përgatitjen e projekt dokumentit të PBA-së, i cili përdoret nga NJVV-ja për të realizuar alokimin strategjik burimeve midis programeve me qëllim përgatitjen e planeve afatmesme të shpenzimeve dhe buxhetit vjetor gjatë fazës teknike të përgatitjes së këtij dokumenti. Në fund të kësaj faze, dokumenti i PBA-së bëhet publik në faqen e internetit të



NJVQV-ve për qëllime konsultimi, si dhe dërgohet në MF, brenda datës 1 qershor e cila përgatit komente dhe rekomandiime.

Faza 2 e procesit të PBA-së, zhvillohet midis Korrikut dhe Shtatorit. Kjo është faza teknike gjatë së cilës ekipet e menaxhimit të programeve të njësisë vendore marrin vendimet përfundimtare mbi planet për ofrimin e shërbimeve publike gjatë tre viteve të ardhshme. Gjatë kësaj faze përfshihen vendimet mbi përmbajtjen e projekt buxhetit vjetor që do t'i paraqiten GMS të NJVQV-së. Në përfundim të kësaj faze, përgatitet një version i rishikuar i dokumentit të PBA-së, i cili përdoret nga NJVQV për të vendosur mbi detajet në lidhje me shërbimet publike që do ofrohen si dhe alokimin e shpenzimeve që do të bëhen pjesë e Buxhetit Vjetor. Dokumenti i Rishikuar i PBA-së bëhet publik në faqen e internetit të NJVQV-ve për qëllime konsultimi.

Faza 3 e procesit të PBA-së dhe Buxhetit Vjetor përshkon periudhën nga tetori deri në muajin dhjetor kur NJVQV-ja, merret me finalizimin e dokumentit të PBA-së, si dhe miratimin e Buxhetit Vjetor. Gjatë kësaj faze, GMS përgatit një version përfundimtar të PBA-së në përputhje me vendimet e Këshillit të NJVQV-së. Projekt buxheti Vjetor është viti i parë i

Projekt Buxhetit Afatmesëm dhe i paraqitet Këshillit të NJVQV-në për miratim (jo më vonë se data 30 nëntor) në një format standard (siç përcaktohet në Udhëzimin e MF). Një version përfundimtar i dokumentit të PBA-së (përfshirë Buxhetin Vjetor) publikohet dhe i vihet në dispozicion publikut të gjerë përmes faqes së internetit të NJVQV-së

<sup>2</sup> 'Afatgjatë' I referohet një kohe të specifikuar nga Drejtuesi i Programit, që shkon përtej periudhës 3-vjeçare të programit buxhetor afatmesëm.

<sup>3</sup> Për tu specifikuar për secilin vit të periudhës 3-vjeçare të programit buxhetor afatmesëm.

<sup>4</sup> Udhëzimi Nr. 23, datë 30.07.2018 i Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë për "Procedurat Standarte të Përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore", i ndryshuar.

## 2. VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM I BASHKISË

### 2.1 Situata E Njesisë Së Vetëqeverisjes Vendore

Bashkia e Vlorë është pjesë e Qarkut të Vlorës dhe përbëhet nga 9 njësi administrative, nga të cilat pesë janë në qytet (rajonet) dhe katër janë ish komunat : Orikum, Shushicë, Novoselë, dhe Qendër Vlorë. Bashkia Vlorë ka 37 fshatra përfshirë edhe ishullin e Sazanit. Bashkia e Vlorës kufizohet në veri me Fierin, në lindje me Selenicën dhe në jug me Himarën. Ka një sipërfaqe prej 616.85 km<sup>2</sup>. Bashkia e Vlorës ka sipas Gjendjes Civile 258,350 banorë ose 87,517 familje, ku 81.4 % e popullsisë është urbane.



Vlora është qyteti ku deti Adriatik e Jonin përqafohen, është një ndër vendet më të bukura dhe historikisht më të rëndësishme të Shqipërisë. Vlora është një port i lashtë, një qendër kulturore dhe një destinacion turistik që të magjeps me bukurinë e saj natyrore dhe trashëgiminë historike. Plazhet e Vlorës janë ndër më të frekuentuarat në Shqipëri, me ujëra të kristaltë.

Parku Kombëtar i Llogarasë, vetëm pak kilometra larg, ofron ajër të freskët malor. Muzeu Kombëtar i Pavarësisë ndodhet pikërisht aty ku u shpall pavarësia e Shqipërisë më 28 nëntor 1912, një simbol i identitetit kombëtar. Kalaja e Kaninës, një fortesë e lashtë me pamje panoramike mbi qytetin dhe detin, është dëshmi e historisë së pasur të rajonit. Ishulli i Sazanit dhe gadishulli i Karaburunit janë gjithashtu destinacioneve për një aventurë të paharrueshme për adhuruesit e natyrës dhe historisë ushtarake.

Vlora është një qytet plot gjallëri, me festivale muzikore, aktivitete artistike dhe ekspozita që pasqyrojnë shpirtin krijues të komunitetit. Polifonia vlonjate, e njohur si pasuri e UNESCO-s, është një element i veçantë i trashëgimisë shpirtërore dhe një komunitet mikpritës. Gastronomia

lokale është një përzierje e shijeve mesdhetare dhe shqiptare, ku peshku i freskët dhe ullinjë janë protagonistë.

Qyteti po zhvillohet me projekte moderne si **VloraMarina**, duke e kthyer në një destinacion turistik të nivelit ndërkombëtar. Megjithatë, mbetet një vend ku mikpritja tradicionale dhe bukuria natyrore bashkohen për të krijuar një përvojë të paharrueshme.

## 2.2 Çështje Kryesore për Projektet dhe Politikat e Bashkisë

Kapitali njerëzor përbën burimin themelor të zhvillimit të qëndrueshëm të Bashkisë Vlorë. Në këtë kuadër, strategjia e zhvillimit vendor konceptohet mbi parimin e gjithëpërfshirjes, duke e vendosur qytetarin në qendër të procesit të planifikimit dhe vendimmarrjes.

Bashkia ka ndjekur një qasje gjithëpërfshirëse, të bazuar në komunikim të vazhdueshëm me komunitetin dhe në forcimin e bashkëpunimit me biznesin dhe organizatat e shoqërisë civile. Këto forma bashkëpunimi kanë kontribuar në përmirësimin e cilësisë së vendimmarrjes dhe në rritjen e transparencës institucionale.

Gjithashtu, është vërejtur një angazhim në rritje për mbështetjen e iniciativave qytetare dhe promovimin e pjesëmarrjes publike, si elemente të rëndësishme për forcimin e qeverisjes vendore dhe rritjen e besimit të qytetarëve ndaj institucioneve.

Komponenti urban i strategjisë e shikon Bashkinë Vlorë si më poshtë:

- Zhvillimin e qytetit të Vlorës si qendër moderne administrative, ekonomike dhe turistike e jugut të Shqipërisë;
- Integrimin urban të zonave periferike dhe njësive administrative në një sistem funksional dhe të lidhur;
- Zhvillimin e Lungomares dhe vijës bregdetare si hapësira publike cilësore për banorët dhe vizitorët;
- Përmirësimin e infrastrukturës dhe shërbimeve në Orikum, Novoselë dhe zonat rurale;
- Krijimin e zonave të reja të banimit dhe shërbimeve në përputhje me standardet bashkëkohore të planifikimit urban;
- Mbrojtjen dhe zgjerimin e hapësirave të gjelbra urbane.

Komponenti turistik i strategjisë e shikon Bashkinë Vlorë si më poshtë:

- Vlorën si një nga destinacionet kryesore turistike të Mesdheut;
- Promovimin e Rivierës së Vlorës dhe të Gjirit të Vlorës si produkte turistike me vlerë të lartë;
- Zhvillimin e turizmit detar, të jahteve dhe të kroçierave;
- Mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë historike, kulturore dhe natyrore;
- Zhvillimin e turizmit të aventurës, ekoturizmit dhe aktiviteteve sportive në natyrë;
- Rritjen e cilësisë së shërbimeve turistike dhe zgjatjen e sezonit turistik gjatë gjithë vitit.

Komponenti ekonomik i strategjisë e shikon Bashkinë Vlorë si më poshtë:

- Lehtësimin e procedurave administrative për bizneset dhe investitorët;



- Mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme përmes programeve të zhvillimit dhe inovacionit;
- Nxitjen e investimeve në sektorët e turizmit, logjistikës, energjisë dhe shërbimeve;
- Krijimin e qendrave të mbështetjes për sipërmarrjen dhe startup-et;
- Forcimin e lidhjeve ekonomike ndërmjet portit, aeroportit dhe tregjeve rajonale;
- Promovimin e ekonomisë blu dhe aktiviteteve të lidhura me detin.

Komponenti bujqësor i strategjisë e shikon Bashkinë Vlorë si më poshtë:

- Ruajtjen e tokës bujqësore dhe përdorimin e qëndrueshëm të saj;
- Modernizimin e bujqësisë dhe rritjen e produktivitetit;
- Mbështetjen e kultivimit të ullirit, agrumeve, vreshtarisë dhe produkteve tradicionale;
- Zhvillimin e agroturizmit dhe lidhjen e tij me sektorin turistik;
- Krijimin e tregjeve moderne për grumbullimin dhe shpërndarjen e produkteve bujqësore;
- Mbështetjen e fermerëve në certifikimin dhe promovimin e produkteve lokale.

Komponenti mjedisor dhe i ujërave synon:

- Mbrojtjen e vijës bregdetare nga erozioni dhe ndotja;
- Menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve ujore dhe furnizimin cilësor me ujë të pijshëm;
- Mbrojtjen e lagunës së Nartës dhe ekosistemeve natyrore;
- Përmirësimin e sistemit të kanalizimeve dhe trajtimit të ujërave të ndotura;
- Rritjen e ndërgjegjësimit për mbrojtjen e mjedisit dhe ekonominë e gjelbër.

Komponenti i infrastrukturës synon:

- Shndërrimin e Vlorës në një nyje moderne të transportit detar, ajror dhe rrugor;
- Përmirësimin e lidhjes me Aeroportin Ndërkombëtar të Vlorës dhe Portin e Vlorës;
- Modernizimin e rrjetit rrugor urban dhe rural;
- Zgjerimin e infrastrukturës energjetike dhe dixhitale;
- Ofrimin e shërbimeve publike moderne për të gjithë qytetarët e bashkisë.

Vizioni 2035

Vlora do të jetë një qytet bregdetar modern, i gjelbër dhe konkurrues, qendër e turizmit, ekonomisë detare, kulturës dhe inovacionit në Shqipëri, duke garantuar cilësi të lartë jetese për qytetarët dhe zhvillim të qëndrueshëm për brezat e ardhshëm.



### 3. Orientimi Afatgjatë i Bashkisë Vlorë

#### 3.1 Strategjia e Zhvillimit Afatgjatë

Plani i Përgjithshëm Kombëtar orienton zhvillimin e Bashkisë Vlorë sipas fushave strategjike të mëposhtme:

##### 1. Zhvillimi Ekonomik

Bashkia Vlorë është pjesë e korridorit ekonomik të Jugut të Shqipërisë dhe profilizohet në turizëm, ekonomi detare, tregti, shërbime, energji, bujqësi dhe logjistikë. Pozicioni strategjik bregdetar, Porti i Vlorës dhe Aeroporti Ndërkombëtar i Vlorës krijojnë potencial për zhvillim ekonomik rajonal dhe ndërkombëtar.

##### 2. Turizmi

Turizmi përbën sektorin prioritar të zhvillimit ekonomik të Bashkisë Vlorë. Strategjia synon:

- Zhvillimin e Vlorës si destinacion turistik gjatë gjithë vitit;
- Promovimin e Rivierës së Vlorës dhe Gjirit të Vlorës;
- Zhvillimin e turizmit detar, kulturor, historik dhe natyror;
- Mbrojtjen dhe valorizimin e trashëgimisë kulturore, historike dhe natyrore;
- Zgjerimin e ofertës turistike përmes agroturizmit, ekoturizmit dhe aktiviteteve sportive.

##### 3. Bujqësia

Strategjia synon:

- Ruajtjen e fondit të tokës bujqësore;
- Modernizimin e prodhimit bujqësor;
- Mbështetjen e sektorit të ullishtarisë, agrumeve, vreshtarisë dhe blegtorisë;
- Krijimin e zinxhirit të vlerës midis bujqësisë, përpunimit agro-ushqimor dhe turizmit;
- Nxitjen e produkteve vendase me identitet territorial.

##### 4. Transporti

Zhvillimi i transportit orientohet drejt përmirësimit të lëvizshmërisë lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare. Projektet strategjike prioritare për Bashkinë Vlorë përfshijnë:

- Zhvillimin e Korridorit Blu si aksi kryesor turistik bregdetar që lidh Vlorën me pjesën tjetër të bregdetit shqiptar;
- Përmirësimin e lidhjes së Vlorës me korridoret kombëtare dhe rajonale të transportit;
- Zhvillimin e Portit të Vlorës si port turistik, tregtar dhe marinë moderne;
- Integrimin funksional të Aeroportit Ndërkombëtar të Vlorës me rrjetin kombëtar të transportit;
- Modernizimin e infrastrukturës rrugore urbane dhe rurale;
- Krijimin e sistemeve alternative të mobilitetit të qëndrueshëm, përfshirë korsitë e biçikletave dhe transportin publik modern.



## 5. Zhvillimi Urban

PPK përkthehet në Bashkinë Vlorë në:

- Rigjenerimin urban të zonave ekzistuese;
- Zhvillimin e qëndrueshëm të vijës bregdetare;
- Konsolidimin e qendrave urbane dhe njësive administrative;
- Përmirësimin e hapësirave publike dhe zonave të gjelbra;
- Ruajtjen e identitetit historik dhe kulturor të qytetit.

## 6. Zhvillimi Natyror dhe Mjedisor

Zhvillimi Natyror dhe Mjedisor Strategjia synon:

- Mbrojtjen e ekosistemeve bregdetare dhe detare,
- Mbrojtjen dhe promovimin e Lagunës së Nartës,
- Menaxhimin e integruar të mbetjeve urbane,
- Krijimin e korridoreve ekologjike dhe rrjeteve të hapësirave të gjelbra,
- Mbrojtjen nga erozioni bregdetar dhe efektet e ndryshimeve klimatike.

### *Vizioni*

Bashkia Vlorë synon të bëhet:

Qendra kryesore e ekonomisë detare dhe turizmit të qëndrueshëm në Shqipëri, një strategjike e transportit detar, ajror dhe rrugor në Jugun e Shqipërisë dhe rajonin e Mesdheut si dhe qendër urbane moderne, konkurruese dhe gjithëpërfshirëse që ofron cilësi të lartë jetese për qytetarët dhe vizitorët.

Realizimi i vizionit të Bashkisë Vlorë 2035 do të kryhet nëpërmjet zbatimit të tre politikave strategjike zhvillimore.

### **Politika Strategjike I:**

#### **Vlora, porta detare dhe turistike e Shqipërisë Jugore**

Vlora do të konsolidohet si një strategjike kombëtare dhe ndërkombëtare për turizmin, transportin dhe ekonominë detare nëpërmjet:

- zhvillimit të Portit të Vlorës dhe marinave turistike;
- integritit të Aeroportit Ndërkombëtar të Vlorës në rrjetet turistike dhe ekonomike;
- promovimit të Vlorës në tregjet ndërkombëtare turistike;
- zhvillimit të infrastrukturës mbështetëse për transportin dhe turizmin;
- forcimit të lidhjeve me korridoret kombëtare dhe rajonale të transportit.

Bashkia do të ndërhyjë:

### **Në procesin e planifikimit:**

Duke bashkëpunuar me qeverinë qendrore, partnerët ndërkombëtarë dhe institucionet financiare për realizimin e projekteve strategjike.

**Në procesin e zhvillimit:**

Duke siguruar infrastrukturën urbane dhe territoriale mbështetëse për investimet strategjike.

**Politika Strategjike II:****Vlora atraktive për investitorët dhe zhvillimin ekonomik**

Bashkia Vlorë do të krijojë një klimë të favorshme për investimet private dhe publike.

Prioritet do të kenë:

- investimet në turizëm cilësor;
- ekonomia blu dhe aktivitetet detare;
- agroindustria dhe agroturizmi;
- ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.

Bashkia do të bashkëpunojë me institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare për tërheqjen e investimeve strategjike dhe krijimin e vendeve të reja të punës.

**Politika Strategjike III:**

Vlora për qytetarët, Bashkia Vlorë do të ofrojë shërbime publike moderne, efikase dhe gjithëpërfshirëse.

Objektivat kryesore janë:

- Rritja e cilësisë së jetës së qytetarëve;
- përmirësimi i arsimit dhe formimit profesional;
- rritja e aksesit në shërbimet publike;
- zhvillimi i infrastrukturës publike;
- rritja e pjesëmarrjes qytetare në vendimmarrje;
- garantimi i mbrojtjes sociale dhe përfshirjes së grupeve vulnerabël.

Bashkia Vlorë synon të ndërtojë një qytet modern, të gjelbër, të sigurt dhe konkurrues, që ofron mundësi zhvillimi ekonomik dhe mirëqenie për të gjithë qytetarët e saj.

Ky variant është shkruar me gjuhë dhe strukturë shumë të afërt me dokumentet zyrtare të PZHK/PPV dhe mund të përdoret drejtpërdrejt si kapitull i Projekt-Buxhetit Afatmesëm 2027–2029 ose i Strategjisë së Zhvillimit të Bashkisë Vlorë, me përshtatje të mëtejshme sipas objektivave specifike të bashkisë.

**Raporti: PBA1 - Tavanet Përgatitore të PBA**

NJVQV: 146 - Bashkia Vlorë

PBA: 2027 - 2029

Vlerat paraqiten në: 000 ALL

	2027	2028	2029
<b>01110 - Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi</b>			
Shpenzime Personeli (600-601)	606,906	628,148	650,133
Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)	407,359	427,722	449,105
Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	733,806	770,496	804,022
<b>Tavanet e Përgjithshme</b>	<b>1,748,071</b>	<b>1,826,366</b>	<b>1,903,260</b>
<b>03280 - Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile</b>			
Shpenzime Personeli (600-601)	78,673	81,427	84,277
Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)	19,845	20,735	21,674
Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	0	0	0
<b>Tavanet e Përgjithshme</b>	<b>98,518</b>	<b>102,162</b>	<b>105,951</b>
<b>04240 - Menaxhimi i ujitjes dhe kullimit</b>			
Shpenzime Personeli (600-601)	24,223	25,071	25,948
Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)	28,853	30,296	31,780
Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	0	0	0
<b>Tavanet e Përgjithshme</b>	<b>53,076</b>	<b>55,367</b>	<b>57,728</b>
<b>04260 - Menaxhimi i pyjeve dhe kullotave</b>			
Shpenzime Personeli (600-601)	17,934	18,562	19,212
Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)	1,260	1,323	1,389
Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	0	0	0
<b>Tavanet e Përgjithshme</b>	<b>19,194</b>	<b>19,885</b>	<b>20,601</b>

**Raporti: PBA1 - Tavanet Përgatitore të PBA**

NJVQV: 146 - Bashkia Vlorë

PBA: 2027 - 2029

Vlerat paraqiten në: 000 ALL

	2027	2028	2029
<b>04520 - Rrjeti Rrugor Rural</b>			
Shpenzime Personeli (600-601)	3,677	3,806	3,939
Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)	2,100	2,205	2,303
Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	0	0	0
<b>Tavanet e Përgjithshme</b>	<b>5,777</b>	<b>6,011</b>	<b>6,242</b>
<b>05100 - Menaxhimi i mbetjeve</b>			
Shpenzime Personeli (600-601)	463,527	479,750	496,542
Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)	336,487	352,302	367,452
Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	162,330	170,447	175,576
<b>Tavanet e Përgjithshme</b>	<b>962,344</b>	<b>1,002,499</b>	<b>1,039,570</b>
<b>06260 - Shërbimet Publike Vendore</b>			
Shpenzime Personeli (600-601)	144,481	149,538	154,771
Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)	226,332	237,648	249,531
Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	76,188	79,997	83,997
<b>Tavanet e Përgjithshme</b>	<b>447,001</b>	<b>467,183</b>	<b>488,299</b>
<b>08130 - Sport dhe argëtim</b>			
Shpenzime Personeli (600-601)	21,644	22,401	23,186
Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)	57,026	59,877	62,871
Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	0	0	0
<b>Tavanet e Përgjithshme</b>	<b>78,670</b>	<b>82,278</b>	<b>86,057</b>

**Raporti: PBA1 - Tavanet Përgatitore të PBA**

NJVQV: 146 - Bashkia Vlorë

PBA: 2027 - 2029

Vlerat paraqiten në: 000 ALL

	2027	2028	2029
<b>08220 - Trashëgimia kulturore, monumentet, muzetë dhe bibliotekat</b>			
Shpenzime Personeli (600-601)	80,286	83,096	86,004
Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)	46,667	49,001	51,451
Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	9,005	9,455	9,646
<b>Tavanet e Përgjithshme</b>	<b>135,958</b>	<b>141,552</b>	<b>147,101</b>
<b>09120 - Arsimi bazë përfshirë sistemin e arsimit parashkollorollorin)</b>			
Shpenzime Personeli (600-601)	476,738	493,423	510,693
Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)	89,430	93,499	97,659
Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	240,575	252,604	260,206
<b>Tavanet e Përgjithshme</b>	<b>806,743</b>	<b>839,526</b>	<b>868,558</b>
<b>09230 - Arsimi i mesëm i përgjithshëm</b>			
Shpenzime Personeli (600-601)	69,996	72,446	74,981
Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)	12,168	12,720	13,288
Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	0	0	0
<b>Tavanet e Përgjithshme</b>	<b>82,164</b>	<b>85,166</b>	<b>88,269</b>
<b>10430 - Kujdesi social për familjet dhe fëmijët</b>			
Shpenzime Personeli (600-601)	81,902	84,768	87,735
Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)	21,561	22,639	23,565
Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	2,074	2,178	2,230
<b>Tavanet e Përgjithshme</b>	<b>105,537</b>	<b>109,585</b>	<b>113,530</b>

**Raporti: PBA1 - Tavanet Përgatitore të PBA**

NJVQV: 146 - Bashkia Vlorë

PBA: 2027 - 2029

Vlerat paraqiten në: 000 ALL

	2027	2028	2029
<b>04910 - Fondi Rezerve</b>			
Shpenzime Personeli (600-601)	0	0	0
Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)	61,194	64,254	67,466
Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	0	0	0
<b>Tavanet e Përgjithshme</b>	<b>61,194</b>	<b>64,254</b>	<b>67,466</b>
<b>04940 - Fondi Kontigjence</b>			
Shpenzime Personeli (600-601)	0	0	0
Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)	61,194	64,254	67,466
Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	0	0	0
<b>Tavanet e Përgjithshme</b>	<b>61,194</b>	<b>64,254</b>	<b>67,466</b>
<b>04130 - Mbështetje për zhvillimin ekonomik</b>			
Shpenzime Personeli (600-601)	0	0	0
Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)	63,053	66,205	69,488
Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	0	0	0
<b>Tavanet e Përgjithshme</b>	<b>63,053</b>	<b>66,205</b>	<b>69,488</b>

Totali i Shpenzime Personeli (600-601)	2,069,987	2,142,436	2,217,421
Totali i Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)	1,434,529	1,504,680	1,576,488
Totali i Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	1,223,978	1,285,177	1,335,677
<b>Tavanet e Përgjithshme</b>	<b>4,728,494</b>	<b>4,932,293</b>	<b>5,129,586</b>

## Raporti: PBA2 - Parashikimi i të Ardhurave

NJVQV: 146 - Bashkia Vlorë

PBA: 2027 - 2029

Vlerat paraqiten në: 000 ALL

	Burimet Buxhetore	2024 Fakti	2025 Fakti	2026 Plani Fillestar	2026 Plani i Rishikuar	2027 Plani	2028 Plani	2029 Plani
<b>1</b>	<b>TË ARDHURA NGA BURIMET E VETA</b>	1,266,559	3,244,412	2,759,046	2,759,046	2,891,576	3,048,848	3,188,385
<b>1.1</b>	<b>TAKSA E PASURISË SË PALUAJTSHME</b>	263,180	325,149	374,262	374,262	378,127	372,235	384,061
1.1.1	Taksa mbi Ndërtesën	195,208	226,471	254,586	254,586	256,856	274,140	283,140
1.1.2	Taksa mbi tokën bujqësore	15,393	19,780	40,337	40,337	41,049	46,031	47,152
1.1.3	Taksa mbi truallin	13,810	15,616	14,339	14,339	14,461	17,828	18,828
1.1.4	Taksa mbi transaksionet e kryera me pasuritë e paluajtshme	38,769	63,282	65,000	65,000	65,761	34,235	34,940
<b>1.2</b>	<b>TAKSA E NDIKIMIT NË INFRASTRUKTURË NGA NDËRTIMET E REJA</b>	284,403	2,156,589	1,256,551	1,256,551	1,261,415	1,311,813	1,421,813
1.2.1	Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	284,403	2,156,589	1,256,551	1,256,551	1,261,415	1,311,813	1,421,813
<b>1.3</b>	<b>TAKSA TË TJERA VENDORE</b>	72,465	102,491	117,826	117,826	118,331	92,585	94,595
1.3.1	Taksa vendore mbi biznesin e vogël	2,137	1,360	1,800	1,800	2,008	4,565	4,575
1.3.2	Taksa vendore në shërbimin hotelier	47,116	74,804	86,352	86,352	86,056	56,240	57,240
1.3.3	Taksa e tabelës	23,212	26,327	29,674	29,674	30,267	31,780	32,780
1.3.4	Taksa vendore mbi të ardhurat e krijuara nga dhuratat, trashëgimi, testamen...	0	0	0	0	0	0	0
1.3.5	Taksa e përkohëshme	0	0	0	0	0	0	0
<b>1.4</b>	<b>TARIFA VENDORE</b>	507,185	513,341	548,762	548,762	658,323	740,647	756,247
1.4.1	Tarifa e menaxhimit të mbetjeve	163,973	266,748	293,845	293,845	300,565	323,899	333,899
1.4.2	Tarifa për zënien e hapësirës publike	152,901	132,865	116,261	116,261	116,979	161,098	162,098
1.4.3	Tarifa për ndriçimin publik	104,812	50,194	49,696	49,696	57,029	62,571	63,571
1.4.4	Tarifa për gjelbërimin	49,875	26,133	24,974	24,974	28,571	31,345	32,345
1.4.5	Tarifa për shërbimet administrative të bashkisë	884	840	1,500	1,500	90,555	95,989	96,989

Zyrtari i të Ardhurave: **FATMIR LLANAJ**

Koordinator i GMS: **JOLJANA LLANAJ**

Kryetari i GMS: **BRUNILDA MERSINI**

## Raporti: PBA2 - Parashikimi i të Ardhurave

NJVQV: 146 - Bashkia Vlorë

PBA: 2027 - 2029

Vlerat paraqiten në: 000 ALL

	Burimet Buxhetore	2024 Fakti	2025 Fakti	2026 Plani Fillestar	2026 Plani i Rishikuar	2027 Plani	2028 Plani	2029 Plani
1.4.6	Tarifa të institucioneve të arsimit	17,461	15,381	28,525	28,525	28,528	28,558	28,958
1.4.7	Tarifa të institucioneve të kulturës dhe sportit	2,242	2,484	4,580	4,580	4,580	4,295	4,395
1.4.8	Tarifa për furnizimin me ujë dhe kanalizime	0	0	0	0	0	0	0
1.4.9	Tarifa për shërbimin e ujitjes dhe kullimit	0	0	900	900	900	900	900
1.4.10	Tarifa e përkohëshme	0	0	0	0	0	0	0
1.4.11	Tarifa e parkimit	6,914	5,718	7,110	7,110	7,323	7,653	7,753
1.4.12	Tarifa të tjera	8,123	12,978	21,371	21,371	23,291	24,339	25,339
<b>1.5</b>	<b>TË ARDHURA NGA ASETET DHE AKTIVITETI EKONOMIK</b>	<b>12,424</b>	<b>14,374</b>	<b>52,457</b>	<b>52,457</b>	<b>50,904</b>	<b>56,748</b>	<b>56,848</b>
1.5.1	Të ardhura nga ndërmarrjet publike	11,904	13,375	12,729	12,729	10,920	11,412	11,412
1.5.2	Të ardhura nga dhënia me qira e asetëve në pronësi të bashkisë	520	999	39,728	39,728	39,984	45,336	45,436
1.5.3	Të ardhura nga partneriteti publik privat	0	0	0	0	0	0	0
1.5.4	Shitja e mallrave dhe shërbimeve	0	0	0	0	0	0	0
1.5.5	Shitja e asetëve financiare	0	0	0	0	0	0	0
1.5.6	Shitja e asetëve fikse të prekshme / paprekshme	0	0	0	0	0	0	0
1.5.7	Të tjera	0	0	0	0	0	0	0
<b>1.6</b>	<b>TË TJERA ADMINISTRATIVE</b>	<b>126,902</b>	<b>132,468</b>	<b>409,188</b>	<b>409,188</b>	<b>424,476</b>	<b>474,821</b>	<b>474,821</b>
1.6.1	Kamatëvonesat	0	0	0	0	0	0	0
1.6.2	Gjoha, sekuestrime dhe zhvendëtime	101,132	132,468	371,338	371,338	386,194	393,573	393,573
1.6.3	Të tjera	25,770	0	37,850	37,850	38,282	81,248	81,248
<b>2</b>	<b>TRANSFERTA NGA BUXHETI QËNDROR</b>	<b>1,284,312</b>	<b>515,036</b>	<b>1,621,719</b>	<b>1,621,719</b>	<b>1,681,058</b>	<b>1,731,836</b>	<b>1,789,572</b>

Zyrtari i të Ardhurave: **FATMIR LLANAJ**

Koordinator i GMS: **JOLJANA LLANAJ**

Kryetari i GMS: **BRUNILDA MERSINI**

Projekt Dokumenti i PBA 2027-2029 – Version Pune (Draft) (Faza I).

## Raporti: PBA2 - Parashikimi i të Ardhurave

NJVQV: 146 - Bashkia Vlorë

PBA: 2027 - 2029

Vlerat paraqiten në: 000 ALL

	Burimet Buxhetore	2024 Fakti	2025 Fakti	2026 Plani Fillestar	2026 Plani i Rishikuar	2027 Plani	2028 Plani	2029 Plani
<b>2.1</b>	<b>TRANSFERTA E PAKUSHTËZUAR E PËRGJITHSHME</b>	798,527	292,586	970,640	970,640	1,016,957	1,067,735	1,118,830
2.1.1	Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme	798,527	267,022	852,421	852,421	898,737	949,515	1,000,610
2.1.2	Rritja e nivelit të pagave	0	25,565	118,220	118,220	118,220	118,220	118,220
2.1.3	Fond shtesë nga Kuvendi	0	0	0	0	0	0	0
<b>2.2</b>	<b>TRANSFERTA E PAKUSHTËZUAR SEKTORIALE</b>	485,785	222,450	651,079	651,079	664,101	664,101	670,742
2.2.1	Konviktet e arsimit parauniversitar	27,628	10,987	29,311	29,311	29,897	29,897	30,196
2.2.2	Arsimi parashkollor - Për Personelin Arsimor	234,246	113,098	332,779	332,779	339,434	339,434	342,829
2.2.3	Arsimi parashkollor - Për stafin mbështetës	81,145	37,699	106,951	106,951	109,090	109,090	110,181
2.2.4	Arsimi parauniversitar	38,948	16,150	49,907	49,907	50,905	50,905	51,415
2.2.5	Mbrojtja nga zjarri	48,566	22,069	69,205	69,205	70,589	70,589	71,295
2.2.6	Mbrojtja sociale	0	0	0	0	0	0	0
2.2.7	Administrimi i pyjeve	7,022	2,891	8,490	8,490	8,660	8,660	8,747
2.2.8	Rrugët	3,344	1,384	3,553	3,553	3,624	3,624	3,660
2.2.9	Ujitja dhe Kullimi	44,886	18,172	50,883	50,883	51,901	51,901	52,420
2.2.10	Klubet shumësportëshe "Partizani" dhe "Studenti"	0	0	0	0	0	0	0
2.2.11	Menaxhimi i mbetjeve urbane	0	0	0	0	0	0	0
2.2.12	Të tjera	0	0	0	0	0	0	0
<b>2.3</b>	<b>TRANSFERTA TË KUSHTËZUARA</b>	0	0	0	0	0	0	0
2.3.1	Për funksione të deleguara	0	0	0	0	0	0	0
2.3.2	Për projekte të veçanta	0	0	0	0	0	0	0

Zyrtari i të Ardhurave: **FATMIR LLANAJ**

Koordinator i GMS: **JOLJANA LLANAJ**

Kryetari i GMS: **BRUNILDA MERSINI**

## Raporti: PBA2 - Parashikimi i të Ardhurave

NJVQV: 146 - Bashkia Vlorë

PBA: 2027 - 2029

Vlerat paraqiten në: 000 ALL

	Burimet Buxhetore	2024 Fakti	2025 Fakti	2026 Plani Fillestar	2026 Plani i Rishikuar	2027 Plani	2028 Plani	2029 Plani
<b>2.4</b>	<b>TRANSFERTË SPECIFIKE</b>	0	0	0	0	0	0	0
2.4.1	Transfertë specifike	0	0	0	0	0	0	0
<b>3</b>	<b>TË ARDHURA NGA TAKSAT E NDARA</b>	144,743	159,947	155,675	155,675	155,860	151,609	151,629
3.1	Taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura	92,539	95,277	97,200	97,200	97,333	98,077	98,087
3.2	Renta minerare	0	0	0	0	0	0	0
3.3	Tatimi mbi të ardhurat personale	52,204	64,670	58,475	58,475	58,527	53,532	53,542
3.4	Të tjera	0	0	0	0	0	0	0
<b>4</b>	<b>GRANTE DHE TRANSFERTA TË TJERA</b>	0	0	0	0	0	0	0
<b>4.1</b>	<b>TRANSFERTA NGA I NJËJTI NIVEL QEVERISJE</b>	0	0	0	0	0	0	0
4.1.1	Transferta nga i njëjti nivel qeverisje	0	0	0	0	0	0	0
<b>4.2</b>	<b>GRANTE TË TJERA TË BRENDSHME</b>	0	0	0	0	0	0	0
4.2.1	Grante të Tjera të Brendshme	0	0	0	0	0	0	0
<b>4.3</b>	<b>GRANTE TË HUAJA</b>	0	0	0	0	0	0	0
4.3.1	Grante të huaja	0	0	0	0	0	0	0
<b>5</b>	<b>HUAMARRJA</b>	0	0	0	0	0	0	0
5.1	Huamarrja afatshkurtër	0	0	0	0	0	0	0
5.2	Huamarrja afatgjatë	0	0	0	0	0	0	0
<b>6</b>	<b>TRASHËGIMI NGA VITI I KALUAR</b>	0	0	0	3,718,721	0	0	0
6.1	Trashëgimi pa destinacion	0	0	0	3,718,721	0	0	0
6.2	Trashëgimi me destinacion	0	0	0	0	0	0	0

Zyrtari i të Ardhurave: **FATMIR LLANAJ**

Koordinator i GMS: **JOLJANA LLANAJ**

Kryetari i GMS: **BRUNILDA MERSINI**

Projekt Dokumenti i PBA 2027-2029 – Version Pune (Draft) (Faza I).

**Raporti: PBA2 - Parashikimi i të Ardhurave**

NJVQV: 146 - Bashkia Vlorë

PBA: 2027 - 2029

Vlerat paraqiten në: 000 ALL

	Burimet Buxhetore	2024 Fakti	2025 Fakti	2026 Plani Fillestar	2026 Plani i Rishikuar	2027 Plani	2028 Plani	2029 Plani
<b>TOTALI I TË ARDHURAVE TË NJVQV</b>		2,695,614	3,919,395	4,536,440	8,255,161	4,728,494	4,932,293	5,129,586

Zyrtari i të Ardhurave: **FATMIR LLANAJ**

Koordinator i GMS: **JOLJANA LLANAJ**

Kryetari i GMS: **BRUNILDA MERSINI**

Projekt Dokumenti i PBA 2027-2029 – Version Pune (Draft) (Faza I).

## Raporti: PBA3 - Shpenzimet e NJVQV dhe Programit sipas Klasifikimit Ekonomik

NJVQV: 146 - Bashkia Vlorë

PBA: 2027 - 2029

Vlerat paraqiten në: 000 ALL

KODI	EMËRTIMI I LLOGARISË	FAKTI 2024	FAKTI 2025	FILLESTAR 2026	RISHIKUAR 2026	PLANI 2027	PLANI 2028	PLANI 2029
	<b>Shpenzime Personeli (600-601)</b>	<b>0</b>	<b>1,465,049</b>	<b>1,999,988</b>	<b>2,314,568</b>	<b>2,069,987</b>	<b>2,142,436</b>	<b>2,217,421</b>
600	Paga, shperblime dhe te tjera shpenzime personeli	0	1,236,942	1,638,255	1,910,565	1,715,055	1,779,851	1,840,458
601	Kontribute per sigurime shoqerore dhe shendetesore	0	228,107	361,733	404,003	354,932	362,585	376,963
	<b>Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)</b>	<b>0</b>	<b>737,336</b>	<b>1,366,217</b>	<b>1,696,784</b>	<b>1,434,529</b>	<b>1,504,680</b>	<b>1,576,488</b>
602	Mallra dhe sherbime te tjera	0	675,927	1,201,688	1,529,967	1,434,529	1,504,680	1,576,488
603	Subvencionet	0	40,854	60,050	108,537	0	0	0
604	Transferime korrente te brendeshme	0	6,468	104,479	58,280	0	0	0
605	Transferimet korrente jashte	0	0	0	0	0	0	0
606	Transferta per buxhetet familiare dhe individet	0	1,723	0	0	0	0	0
609	Rezervat	0	0	0	0	0	0	0
651	Interesa per huamarrje te tjera te brendeshme	0	1,056	0	0	0	0	0
1661	Te dala, huamarrje te tjera afatgjate	0	11,309	0	0	0	0	0
	<b>Shpenzime Kapitale (230-232, 255)</b>	<b>0</b>	<b>440,770</b>	<b>1,170,235</b>	<b>4,243,809</b>	<b>1,223,978</b>	<b>1,285,177</b>	<b>1,335,677</b>
230	Shpenzime per rritjen e aktiveve te qendrueshme te patruzeuara	0	0	0	0	0	0	0
231	Shpenzime per rritjen e aktiveve te qendrueshme te trupezuara	0	440,770	1,170,235	4,243,809	1,223,978	1,285,177	1,335,677
232	Shpenzime transferimet kapitale	0	0	0	0	0	0	0
255	Te dala per hua-dhenie dhe nen-huadhenie te brendeshme	0	0	0	0	0	0	0
	<b>TOTALI</b>	<b>0</b>	<b>2,643,155</b>	<b>4,536,440</b>	<b>8,255,161</b>	<b>4,728,494</b>	<b>4,932,293</b>	<b>5,129,586</b>

Sekretari i GMS: HIQMET HAXHAJ

Koordinator i GMS: JOLJANA LLANAJ

Kryetari i GMS: BRUNILDA MERSINI

Projekt Dokumenti i PBA 2027-2029 – Version Pune (Draft) (Faza I).

## Raporti: PBA3 - Shpenzimet e NJVQV dhe Programit sipas Klasifikimit Ekonomik

NJVQV: 146 - Bashkia Vlorë

Programi: 01110 - Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi

PBA: 2027 - 2029

Vlerat paraqiten në: 000 ALL

KODI	EMËRTIMI I LLOGARISË	FAKTI 2024	FAKTI 2025	FILLESTAR 2026	RISHIKUAR 2026	PLANI 2027	PLANI 2028	PLANI 2029
	<b>Shpenzime Personeli (600-601)</b>	<b>0</b>	<b>426,891</b>	<b>586,383</b>	<b>665,894</b>	<b>606,906</b>	<b>628,148</b>	<b>650,133</b>
600	Paga, shperblime dhe te tjera shpenzime personeli	0	355,057	504,703	573,320	500,697	521,363	539,610
601	Kontribute per sigurime shoqerore dhe shendetesore	0	71,833	81,680	92,574	106,209	106,785	110,523
	<b>Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)</b>	<b>0</b>	<b>394,425</b>	<b>387,965</b>	<b>549,607</b>	<b>407,359</b>	<b>427,722</b>	<b>449,105</b>
602	Mallra dhe sherbime te tjera	0	345,381	355,318	549,607	407,359	427,722	449,105
603	Subvencionet	0	40,854	0	0	0	0	0
604	Transferime korrente te brendeshme	0	6,468	32,647	0	0	0	0
605	Transferimet korrente jashte	0	0	0	0	0	0	0
606	Transferta per buxhetet familiare dhe individet	0	1,723	0	0	0	0	0
609	Rezervat	0	0	0	0	0	0	0
651	Interesa per huamarrje te tjera te brendeshme	0	0	0	0	0	0	0
1661	Te dala, huamarrje te tjera afatgjate	0	0	0	0	0	0	0
	<b>Shpenzime Kapitale (230-232, 255)</b>	<b>0</b>	<b>416,770</b>	<b>471,053</b>	<b>3,425,288</b>	<b>733,806</b>	<b>770,496</b>	<b>804,022</b>
230	Shpenzime per rritjen e aktiveve te qendrueshme te patruazuara	0	0	0	0	0	0	0
231	Shpenzime per rritjen e aktiveve te qendrueshme te trupezuara	0	416,770	471,053	3,425,288	733,806	770,496	804,022
232	Shpenzime transferimet kapitale	0	0	0	0	0	0	0
255	Te dala per hua-dhenie dhe nen-huadhenie te brendeshme	0	0	0	0	0	0	0
	<b>TOTALI</b>	<b>0</b>	<b>1,238,086</b>	<b>1,445,401</b>	<b>4,640,789</b>	<b>1,748,071</b>	<b>1,826,366</b>	<b>1,903,260</b>

## Raporti: PBA3 - Shpenzimet e NJVQV dhe Programit sipas Klasifikimit Ekonomik

NJVQV: 146 - Bashkia Vlorë

Programi: 03280 - Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile

PBA: 2027 - 2029

Vlerat paraqiten në: 000 ALL

KODI	EMËRTIMI I LLOGARISË	FAKTI 2024	FAKTI 2025	FILLESTAR 2026	RISHIKUAR 2026	PLANI 2027	PLANI 2028	PLANI 2029
	<b>Shpenzime Personeli (600-601)</b>	<b>0</b>	<b>62,716</b>	<b>76,013</b>	<b>86,216</b>	<b>78,673</b>	<b>81,427</b>	<b>84,277</b>
600	Paga, shperblime dhe te tjera shpenzime personeli	0	54,633	65,647	74,450	65,299	69,213	69,950
601	Kontribute per sigurime shoqerore dhe shendetesore	0	8,083	10,366	11,766	13,374	12,214	14,327
	<b>Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)</b>	<b>0</b>	<b>3,942</b>	<b>18,900</b>	<b>28,681</b>	<b>19,845</b>	<b>20,735</b>	<b>21,674</b>
602	Mallra dhe sherbime te tjera	0	3,942	18,900	28,681	19,845	20,735	21,674
603	Subvencionet	0	0	0	0	0	0	0
604	Transferime korrente te brendeshme	0	0	0	0	0	0	0
605	Transferimet korrente jashte	0	0	0	0	0	0	0
606	Transferta per buxhetet familiare dhe individet	0	0	0	0	0	0	0
609	Rezervat	0	0	0	0	0	0	0
651	Interesa per huamarrje te tjera te brendeshme	0	0	0	0	0	0	0
1661	Te dala, huamarrje te tjera afatgjate	0	0	0	0	0	0	0
	<b>Shpenzime Kapitale (230-232, 255)</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
230	Shpenzime per rritjen e aktiveve te qendrueshme te patrupezuara	0	0	0	0	0	0	0
231	Shpenzime per rritjen e aktiveve te qendrueshme te trupezuara	0	0	0	0	0	0	0
232	Shpenzime transferimet kapitale	0	0	0	0	0	0	0
255	Te dala per hua-dhenie dhe nen-huadhenie te brendeshme	0	0	0	0	0	0	0
	<b>TOTALI</b>	<b>0</b>	<b>66,658</b>	<b>94,913</b>	<b>114,897</b>	<b>98,518</b>	<b>102,162</b>	<b>105,951</b>

## Raporti: PBA3 - Shpenzimet e NJVQV dhe Programit sipas Klasifikimit Ekonomik

NJVQV: 146 - Bashkia Vlorë

Programi: 04130 - Mbështetje për zhvillimin ekonomik

PBA: 2027 - 2029

Vlerat paraqiten në: 000 ALL

